

Tiranë, më __. __. 2024

Formulari Nr.3

**Autoriteti Kontraktor
ALBCONTROL SHA**

FTESA PËR OFERTË

Autoriteti Kontraktor ALBCONTROL SHA do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar nr. 978/1 Prot. me objekt: “Blerje bilete të transportit ajror ndërkombëtar, me destinacion Washington”.

Data e zhvillimit do të jetë 05.03.2024, ora 13:15 në adresën www.app.gov.al.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

1. Biletë Tiranë – Washington – Tiranë, nisja më datë 10.03.2024 dhe kthimi më datë 20.03.2024, për 6 (gjashtë) persona.
 2. Biletë Tiranë – Washington – Tiranë, nisja më datë 14.03.2024 dhe kthimi më datë 20.03.2024, për 1 (një) person.
- Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentat sipas **shtojcës nr. 1, ku gjeni dhe detajet e itinerareve të fluturimit:**

Shtojca nr. 1

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentat si më poshtë:

- a) Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar me itinerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit si dhe kodin e llogarisë së klientit.

Në rast anullimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, Operatori Ekonomik do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e Itinerarit.

- Shpenzimet e transportit përfshijnë udhëtimin me avion me destinacion Washington, sipas itinerarit si mëposhtë:

- a. Itinerari (1): **Tiranë –Washington – Tiranë, për 6 (gjashtë) persona, si mëposhtë:**

- ***Nisja*** nga Tirana për 6 persona, më datë **10.03.2024**, të bëhet jo më herët se ora 06:00 AM, të ketë jo më shumë se një tranzit (ndalesa në tranzit preferohet të jetë jo më pak se 2 orë dhe jo më shumë se 5 orë).
- ***Kthimi*** nga Washington për 6 persona, më datë **20.03.2024**, të bëhet jo më herët se ora 21:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit (ndalesa në tranzit preferohet të jetë jo më pak se 2 orë dhe jo më shumë se 5 orë).

- b. Itinerari (2): **Tiranë –Washington – Tiranë, për 1 (një) person, si mëposhtë:**

- ***Nisja*** nga Tirana për 1 person, më datë **14.03.2024**, të bëhet jo më herët se ora 06:00 AM, të ketë jo më shumë se një tranzit (ndalesa në tranzit preferohet të jetë jo më pak se 2 orë dhe jo më shumë se 5 orë).
- ***Kthimi*** nga Washington për 1 person, më datë **20.03.2024**, të bëhet jo më herët se ora 21:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit (ndalesa në tranzit preferohet të jetë jo më pak se 2 orë dhe jo më shumë se 5 orë).

- *Preferohet që destinacioni i mbërritjes në Washington të jetë në aeroportin e Dallas.*
- Minimalisht 1 (një) bagazh dore dhe 2 (dy) valixhe bagazh max deri në 20 kg (on board, hand luggage dhe check-in baggage)/për person në vajtje dhe ardhje i përfshirë.
- Klasi ekonomik.

b) Dokumenta të tjera:

- Operatori ekonomik të paraqesë Ekstraktin e QKB-së, ku aktiviteti tregtar të jetë objekt i kësaj procedure si dhe statusi të jetë aktiv.
- Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që është i pajisur me certifikatë akreditimi/marrëveshje lëshuar nga/me International Air Transport Association (I.A.T.A.), të vlefshme për vitin 2024 dhe valideti të jetë i verifikueshëm online.
- Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të kontaktit.
- Në zbatim të pikës 12 të Udhëzimit të APP-së nr. 03, datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”, të ndryshuar, konkretisht: “Me marrjen e njoftimit, ofertuesi duhet t’i përgjigjet autoritetit kontraktor brenda një afati të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë. Ky afat duhet të jetë minimalisht 2 (dy) orë nga momenti i njoftimit të këtij operatori nga komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave”.
- Afati i dorëzimit të dokumentave në sistemin e prokurimit elektronik sipas Ftesës për Ofertë, do të jetë brenda **2 orëve** nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit.

Shënim: Autoriteti Kontraktor në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, do pranojë të likujdojë vetëm fatura elektronike për shërbimin e marrë.

- * Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, apo mosdorëzimi i biletave të udhëtimit sipas termave të referencës dhe grafikut të itinerarit, konsiderohen si kushte për skualifikim.
- * Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, jeni të lutur të njoftoni në sistemin elektronik të app-së brenda afatit të përcaktuar në Ftesën për Ofertë nga shpallja e njoftimit të fituesit.

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Laureta Omeri